



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	30.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtup e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHPK	6429/2021		1/1



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.917/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.917/2021 të datës 09.11.2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e avokatëve "Sejdiu&Qekini ShPK", në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.12.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.917/2021 të datës 09.11.2021 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja sipas Vendimit më numër ref.520/13 të datës 17.10.2013 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtëm (tutje MPJ), është emëruar anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht emërohet të shërbejë në gradën diplomatike "Ministër Këshilltarë", në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Panama, duke filluar nga data 01.11.2013. Me tutje, ankuesja me Vendimin me numër ref.545/13 të datës 01.11.2013 të Ministrit të MPJ-së është emëruar e Ngarkuar për Punë të Përkohshme në Ambasadën e Kosovës në Panama, ndërsa me Dekretin DED-35-2016 të datës 01.12.2016 të Presidentit të Republikës së Kosovës emërohet Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiptotë e Republikës së Kosovës në Panama.

Ankuesja me datë 11.09.2019 parashtron kërkesë për pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej një

(1) viti, për arsye të ngritjes profesionale, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së me Vendimin me numër 115/2019 të datës 19.09.2019, ka aprovuar kërkesën e ankueses të datës 11.09.2019 dhe ka lejuar pezullimin e marrëdhënies së punës për periudhën nga data 01.10.2019 deri 01.10.2020, kurse me Vendimin me numër 128/2019 të datës 24.10.2019 ka bërë sistemimin e përkohshëm të ankueses në pozitën e punës "Udhëheqëse e Departamentit për Siguri dhe NATO, në kuadër të MPJ.

Me kërkesë të ankueses, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së sipas vendimeve nr.ref.159/2021 të datës 18.09.2020 dhe nr.ref.28/2021 të datës 15.02.2021, ka miratuar lejimin e pushimit pa pagesë të ankueses, me qëllim të përkujdesjes dhe trajtimit mjekësor të fëmijës, për periudhën kohore nga data 01.10.2020 deri 30.09.2021. Pas mbarimit të pushimit të lartshënuar, Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së me Vendimin me Nr.ref.196/2021 të datës 11.10.2021 ka bërë sistemimin e përkohshëm të ankueses në pozitën Zyrtare e Lartë në Departamentin për Marrëdhënie dy Palëshe. E pakënaqur me këtë vendim, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Vendimi i atakuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjin Nr.06/L-116 për Zyrtarët Publikë, duke propozuar që Këshilli ta anuloj Vendimin me nr.ref.196/2021 të datës 11.10.2021 dhe ankuesen ta kthej në vendin e punës sipas Vendimit të datës 24.10.2019 dhe 15.02.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.11.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 17.11.2021 Këshilli ka pranuar nga përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes, me Vendimin Nr.65/2021 të datës 23.12.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës A.nr.917/2021 të datës 09.11.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 09.11.2021 me numër A.nr.917/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.11.2021; E-mailin nga B.O. për ankesakpmshck i datës 09.11.2021; Autorizimin e datës 15.10.2021; Vendimin me numër reference 520/13 i datës 17.10.2013; Vendimin me numër 545/13 i datës 01.11.2013; Vendimin për sistemim të përkohshëm me numër 128/2019 i datës 24.10.2019; Vendimin për lejimin e pushimit pa pagesë me nr. reference 159/2020 i datës 18.09.2020; Vendimin për lejimin e pushimit pa pagesë me nr. reference 28/2021 i datës 15.02.2021; E-mail nga Z.R. për B.O. i datës 19.10.2021; E-mail nga SH.M. për A.K. i datës 27.08.2020; E-mail nga Z.R. për SH.M. i datës 27.08.2020; E-mail nga SH.M. për Z.R. i datës 26.08.2020; E-mail nga A.K. për SH.M. i datës 26.08.2020; E-mail nga Zyra e Sekretarit MPJ për Z.R. i datës 24.10.2019; E-mail i datës 25.08.2020; Certifikatën e lindjes e datës 06.05.2020; Certifikatë për L.R.; E-mail nga Z.R. për Zyrën e Sekretarit në MPJ i datës 06.09.2021; Kërkesën për sistemim në pozitë të Udhëheqëses të njërit nga departamentet brenda MPJD me nr. 2567 i datës 01.10.2021; Vendimin për mbarimin e

pushimit pa pagesë me numër reference 196/2021 i datës 11.10.2021; Ankesën drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër protokolli 2753 i datës 19.10.2021; E-mail nga Z.R. për B.O. i datës 04.11.2021; E-mail nga Z.R. për Z.R. i datës 04.11.2021; E-mail nga Zyra e Sekretarit në MPJD për Z.R. i datës 04.11.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 17.11.2021; Kërkesën për pushim pa pagesë e datës 11.09.2019; Vendimin për lejimin e pezullimit të marrëdhënies së punës me numër 115/2019 i datës 19.09.2019; E-mail nga Z.R. për SH.M. i datës 12.02.2021; Raportin mjekësor me nr. 4806; E-mail nga Z.R. për SH.M. i datës 27.08.2020; E-mail nga SH.M. për Z.R. i datës 26.08.2020; E-mail nga A.K. për SH.M. i datës 26.08.2020; E-mail nga Zyra e Sekretarit në MPJ për Z.R. i datës 24.10.2019; E-mail nga SH.M. për A.K. i datës 25.08.2020; Vendimin për mbarimin e pushimit pa pagesë me numër reference 196/2021 i datës 11.10.2021; E-mail nga Zyra e Sekretarit në MPJD për Z.R. i datës 04.11.2021; emaili i datës 23.12.2021 të Menaxherit të BNJ me shkresat e bashkangjitura 1/14, emaili i datës 28.12.2021, Dekreti DED-35-2016 i datës 01.12.2016 të Presidentit të Republikës së Kosovës, Letër Përcjellëse me nr. protokolli 2711 të datës 05.12.2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuese sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Shërbim Civil të Kosovës i zbatueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 4 paragrafi 1 të njëjtit ligj ku parashihet se: "... 4. Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: ..... të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. ...". Ndërsa Ligji Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomantik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-207, konkretisht neni 9 përcakton se: "Anëtarët e Shërbimit Diplomantik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore". dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se të emëruarit politik nuk janë nëpunës civil dhe të njëjtit nuk i nënshtrohen legjislacionit të shërbimit civil.*

Po ashtu edhe Ligji Nr.06/L-116 për Zyrtarët Publikë me nenin 3 paragrafi 2 përcakton se: "Funksionarë publikë, në kuptimin e nenit paragrafit 1.1 të këtij neni, janë: ....2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura" ndërsa me nenin 4 paragrafi 1 po të këtij ligji thuhet se: "Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë", e mbi këtë bazë ligjore, ambasadorët e emëruar dhe të cilat kanë statusin e funksionarit publik, janë të përjashtuar nga dispozitat e Ligjit Nr.06/L-116 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është emëruar anëtare e shërbimit të jashtëm sipas Vendimit më numër ref.520/13 të datës 17.10.2013 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke vazhduar me tej misionin diplomatik si nëpunëse e përkohshme dhe Ambasadore e Republikës së Kosovës sipas Dekretit DED-35-2016 të datës 01.12.2016 të Presidentit të Republikës së Kosovës, mirëpo, me asnjë provë të dorëzuar nga ankuesja dhe organi i punësimit nuk argumentohet se e njëjta i është nënshtruar procedurës së rekrutimit dhe rrjedhimisht është përzgjedhur nëpunëse civile në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme ashtu siç përcaktohej me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, kështu që nisur nga konstatimi se ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses.

Bazuar në rrethanat si me lartë, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.917/2021.

Çlirim Zeka

*Çlirim Zeka*  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

*Ardita Haxhnikaj Demi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses Shoqëria e avokatëve "Sejdiu&Qekini ShPK", Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së